



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Shamo Construction” shpk
Adresa: Njesia Bashkiake Nr. 5, Bulevardi Bajram Curri, Godina 8/1, Kati 10, Ap. 37,
mbrapa Pallateve Agimi , Tirane, Tirana.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim” “Rehabilitimi i rrëshqitjes me murë guri gabion në Fshatin Linzë, Tiranë”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-61236-06-15-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rehabilitimi i rrëshqitjes me murë guri gabion në Fshatin Linzë, Tiranë”.

Fondi limit: 1,311,614.9 (një milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e katërbëdhjetë pikë nëntë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2020, miratuar me VKB Nr. 157 datë 26.12.2019, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”.

Kohëzgjatja e kontratës: 8 (tetë) javë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 26/06/2020 Ora: 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 37 datë 22.05.2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomkisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Shamo Construction” shpk
NUIS L01326020F

Vlera e ofertës = **1,117,591.2** (një milion e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një pikë dy) lekë pa TVSH.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk
NUIS K66613407H

Vlera e ofertës = **1,263,336 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë)** lekë pa TVSH.

Është skualifikuar Operatori ekonomik i mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Euro-Alb” shpk
NUIS K66613407H

- Operatori ekonomik ” **Euro-Alb**” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shtetore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, si më poshtë: 1 (një) punonjës teknik ndërtimi; 2 (dy) punonjës murator”,* pasi për muratorët e deklaruar nuk ka paraqitur diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shtetore.
- Operatori ekonomik ” **Euro-Alb**” shpk nuk plotëson pikën 10 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9).....mjeti kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 ton- 5 ton”,* pasi ka deklaruar një kamion me kapacitet mbajtës 3.5 ton 5 ton ma targë TR3893F, për të cilin nuk ka paraqitur certifikatë pronësie.
- Operatori ekonomik ” **Euro-Alb**” shpk nuk plotëson pikën 10 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9).....mjeti kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7 ton- 10 ton”,* pasi nuk ka deklaruar asnjë kamion me kapacitet mbajtës 7 ton -10 ton.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Shamo Construction” shpk me adresë: “Njesia Bashkiake Nr. 5, Bulevardi Bajram Curri, Godina 8/1, Kati 10, Ap. 37, mbrapa Pallateve Agimi , Tirane”, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1,117,591.2** (një milion e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një pikë dy) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 10 / 07 / 2020

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk u paraqit asnjë ankesë.